

Vesa Shatri

Vesa Shatri është studente në Fakultetin e Studimeve të Sigurisë në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), e fokusuar në fuqizimin e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset shoqërore dhe vendimmarrëse në Ballkanin Perëndimor. Ajo ka zhvilluar përvojë në analizën e politikave, hulumtim dhe bashkëpunim institucional përmes angazhimit në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), ku kontribuon në projekte që lidhen me sigurinë, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut.

Ka përvojë praktike në institucionet shtetërore, përfshirë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ministrinë e Mbrojtjes, ku është angazhuar në fushën e politikave të sigurisë dhe integritit euroatlantik.

Ajo është autore e disa analizave mbi sigurinë rajonale, infrastrukturën kritike, integrimin euroatlantik dhe sfidat bashkëkohore, përfshirë ekstremizmin dhe sigurinë digjitale. Krahas angazhimit akademik dhe profesional, ushtron rol udhëheqës si Kryetare e Këshillit Studentor në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), ku përfaqëson interesat e studentëve dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse.

Me aftësi të zhvilluara në komunikim, udhëheqje dhe bashkëpunim ndërdisiplinor, ajo është e përkushtuar për forcimin e dialogut, mirëkuptimit ndërkulturor dhe bashkëpunimit rajonal ndërmjet të rinjve.